



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026  
ME ZGJEDHJE - SESIONI I

SKEMË VLERËSIMI

Filozofi dhe Sociologji

Varianti A

23 qershor 2026

*Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa*

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	D	D	C	A	C	C	B	C	D	C
Pyetja	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Alternativa e saktë	B	A	A	D	A	C	B	A	D	D

Vlerësimi është 1 pikë për çdo përgjigje të saktë

*Pyetjet me zhvillim*

*Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikë, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.*

Sociologji

Pyetja 11

Model përgjigjeje

- Normë udhëzuese.
- Mënyra e veshjes në këtë rrethanë sociale nuk i detyron individëve se çfarë duhet të bëjnë, por i udhëzon në bazë të një etike veshje për të respektuar këtë ritual.

Nxënësi fiton:

- 2 pikë nëse përcakton llojin e normës dhe shpjegon pse;  
1 pikë nëse përcakton llojin e normës OSE shpjegon pse.  
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12****Model përgjigjeje**

- Zhvillojnë qëndrime etike dhe sjellje të përgjegjshme ndaj komunitetit ku jetojnë.
- Përforcojnë aftësitë e socializimit përmes përfshirjes në aktivitete jashtë kurrikulës mësimore.
- Nxënësit mësojnë të ndërveprojnë me individë të ndryshëm dhe të respektojnë diversitetin shoqëror.
- Përvetësojnë vlera si solidariteti, përgjegjësia qytetare dhe kujdesi për mjedisin (programi i fshehtë).
- Nxënësit zhvillojnë aftësi bashkëpunimi dhe pune në grup gjatë veprimtarive të përbashkëta në komunitet.
- Etj.

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse shpjegon dy funksione të shkollës në shoqërim;

**1 pikë** nëse shpjegon një funksion të shkollës në shoqërim;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13****Model përgjigjeje**

- Marrëdhënia me norma kulturore: Në shek. XIX normat patriarkale përjashtonin gratë nga universiteti. Në ditët e sotme respektohet barazia gjinore dhe përjashtimi nga universiteti për shkak të gjinisë është i papranueshëm.
- Rrethanat shoqërore: Struktura patriarkale e shoqërisë dhe institucionet e kohës përcaktonin kufizimin e grave në arsim.
- Pozita shoqërore: Statusi gjinor ndikonte në të drejtat e aksesit në arsim. Burrat ishin në pozita të privilegjuara në raport me gratë, të cilave nuk u lejohej arsimimi në universitet.
- Ndryshimet në rrjedhën e kohës: Me zhvillimet shoqërore dhe ligjore theksohet rëndësia e barazisë gjinore, duke sjellë një ndryshim në konceptimin e sjelljes deviante. Diferencimi i gjinive për qasje në arsim sot konsiderohet sjellje deviante.

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë** nëse analizon katër faktorë;

**3 pikë** nëse analizon tri faktorë;

**2 pikë** nëse analizon dy faktorë;

**1 pikë** nëse analizon një faktor;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14****Model përgjigjeje****Endogame**

- ndikon në forcimin e unitetit brenda grupit shoqëror;
- ndikon në ruajtjen e normave,
- ruajtja e vlerave kulturore tradicionale
- Forcimi i lidhjeve brenda komunitetit që bashkëndan të njëjtat tradita dhe vlera.
- Etj.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse përcakton formën e martesës dhe identifikon dy përparësi;

**2 pikë** nëse përcakton formën e martesës dhe identifikon një përparësi; nëse identifikon dy përparësi;

**1 pikë** nëse përcakton formën e martesës; nëse identifikon një përparësi;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 15

#### Model përgjigjeje

- Zëvendësimi dhe automatizimi i punëve tradicionale. Shumë punë që më parë kryheshin nga njerëzit, tashmë realizohen nga programe kompjuterike dhe sisteme inteligjente. Si pasojë janë reduktuar disa pozicione pune dhe në disa raste kërkohen aftësi të reja nga punonjësit.
- Kufizimi i kontakteve të drejtpërdrejta njerëzore në punë. Përmes përdorimit të kompjuterëve dhe platformave digjitale, shumë shërbime kryhen online, duke kufizuar ndërveprimin fizik midis punonjësve ose shërbimin me klientët.
- Rritje e automatizimit dhe e kontrollit digjital të punës. Proceset e punës zhvillohen gjithnjë e më shumë duke përdorur sistemet e automatizuara. Teknologjia mundëson edhe mbikëqyrje dhe vlerësim më të saktë të performancës së punonjësve.
- Etj.

#### Nxënësi fiton:

**3 pikë** nëse analizon tri drejtime në të cilat zhvillimet teknologjike ndikojnë në proceset e punës;

**2 pikë** nëse analizon dy drejtime në të cilat zhvillimet teknologjike ndikojnë në proceset e punës;

**1 pikë** nëse analizon një drejtim në të cilin zhvillimi teknologjik ndikon në proceset e punës;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

### Pyetja 16

#### Model përgjigjeje

- Sistemin e klasave.
- Jo. Parimi i meritokracisë konsiston në arritjen e një niveli më të lartë në bazë të aftësisë dhe talentit personal. Shpërblimi në këtë rast mund të jenë në të ardhura, prestigj. Katër elementët e statusit në sociologji lidhen me pasurinë, prestigjin profesional, arsimin dhe pushtetin, megjithatë nuk ka një përputhje të plotë gjithmonë me meritokracinë. Disa individë mund të jenë shumë të pasur, por u mungon prestigji profesional, etj., ose disa figura të ekranit kanë influencë në botën mediatike, por nuk kanë pasuri.
- Etj.

#### Nxënësi fiton:

**3 pikë** nëse përcakton sistemin dhe argumenton përgjigjen;

**2 pikë** nëse përcakton sistemin dhe përgjigjet "jo"; nëse argumenton përgjigjen;

**1 pikë** nëse përcakton sistemin OSE përgjigjet "jo";

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 17****Model përgjigjeje**

- **Pasurimi i spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore**-në shoqëritë tradicionale njerëzit orientohen në bazë të respektimit të kriterëve të botëkuptimit fetar, të respektimit të traditave. Në shoqëritë moderne njerëzit kultivojnë qasjen e botëkuptimit racional shkencor.
- **Venitja e bashkësive të vogla tradicionale** - Në shoqërinë tradicionale njerëzit jetonin në bashkësi solidare, të izoluar për mungesë të mjeteve të transportit. Ata kalonin kohë së bashku, ndanin bashkë gëzimet e hidhërimet, mbështeteshin në folklor, ndërsa opinioni publik, që bazohej tek thashethemet, luante një rol shumë të rëndësishëm. Ndërsa, në kohët moderne, autovetura, telefoni, interneti etj., i afrojnë anëtarët e bashkësive të vogla fshatare me qendrën, duke shmangur izolimin. Njerëzit janë në kontakt me të rejtat dhe mënyrën qytetare të jetesës, duke ndryshuar mentalitet. Shumë prej tyre zhvendosen drejt qyteteve.
- **Zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake** - Në shoqërinë tradicionale njerëzit besonin te perënditë dhe fati. Ata varehin nga përkatësia klasore e familjes. Respektonin të njëjtat tradita zakonore, mënyra veshjeje dhe të menduari. Ndërsa, në shoqërinë moderne njerëzit kanë mundësi të gjera dhe janë të lirë të zgjedhin vetë vendbanimin, profilin e shkollimit, profesionin, mënyrën ose "stillin e jetesës" etj., që Bergeri e quajti individualizim të mënyrës së jetesës. Njerëzit, sidomos të rinjtë, zhvendosen nga vendlindja, për një jetë më të mirë.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse shpjegon tri tiparet e shoqërisë moderne;

**2 pikë** nëse shpjegon dy tiparet e shoqërisë moderne;

**1 pikë** nëse shpjegon një tipar të shoqërisë moderne;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

**Filozofi****Pyetja 28****Model përgjigjeje**

- Tezë: Pohimi fillestar ose ideja bazë që paraqitet si e vërtetë në një debat apo situatë shoqërore. Al shihet si mjet që rrit efikasitetin dhe përparimin teknologjik.
- Antitezë: qëndrimi kundërshtues që sfidon dhe mohon tezën. Qëndrimi kundërshtues që e vë në pikëpyetje dhe e mohon tezën, duke krijuar konflikt idesh në procesin dialektik. Al paraqet rreziqe për punësimin, etikën dhe kontrollin njerëzor.
- Sintezë: zgjidhja që bashkon dhe tejkalon tezën dhe antitezën në një nivel më të lartë kuptimi. Zgjidhja përfundimtare që tejkalon kontradiktën midis tezës dhe antitezës, duke i bashkuar dhe zhvilluar ato në një nivel më të lartë kuptimi. Al duhet të përdoret në mënyrë të rregulluar dhe të kontrolluar, duke balancuar përfitimet me mbrojtjen e njeriut.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse analizon tri elementë;

**2 pikë** nëse analizon dy elementë;

**1 pikë** nëse analizon një element;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 29****Model përgjigjeje**

- Burimi i lëvizjes- ajo që lëviz është vënë në lëvizje nga një objekt tjetër e kështu me radhë, për të arritur te origjina e lëvizjes që është Zoti.
- Shkaku dhe pasoja- veprimet kanë një shkak veprues dhe kështu shkohet deri në pafundësi, ndaj duhet pohuar se shkaku i parë veprues është Zoti.
- Qenia e domosdoshme- të gjitha qeniet janë të mundshme ose të rastit, por që të ekzistojnë e mundshmjat duhet të ekzistojë një qenie e domosdoshme, që shkak të domosdoshëm të saj ka vetëm veten e duke qenë domosdoshmëri për gjërat e tjera: ky është Zoti.
- Përsosmëria- krahasimi i vlerave është i mundshëm vetëm në saj të ekzistencës së vlerës që mishëron plotësinë, përsosmërinë. Këto karakteristika në nivelin më të lartë i ka vetëm Zoti.

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë** nëse shpjegon katër prova;

**3 pikë** nëse shpjegon tri prova;

**2 pikë** nëse shpjegon dy prova;

**1 pikë** nëse shpjegon një provë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 30****Model përgjigjeje**

- Synonin edukimin, vetëdijesimin.
- Trajtuan natyrën subjektive të moralit.
- Shprehën kritikë ndaj mitologjisë tradicionale.
- Orientonin mendimin kah arsyetimit, logjikës, kritikës.
- Bazoheshin në parimin se e vërteta është subjektive.
- U përqendruan te suksesi në jetën publike dhe politike.
- Argumentonin qëndrimet e tyre në mënyrë bindëse (retorikë).
- Prireshin kah njohurive praktike sesa ndaj të vërtetave teorike.
- Trajtonin argumentet në mënyra të ndryshme, për t'i kthyer ato në favorin e tyre.
- Ishin skeptik për ekzistencën e perëndive (Njeriu është masë e të gjitha gjërave-Protagora).

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë** nëse identifikon katër tipare kryesore;

**3 pikë** nëse identifikon tri tipare kryesore;

**2 pikë** nëse identifikon dy tipare kryesore;

**1 pikë** nëse identifikon një tipar kryesore;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 31****Model përgjigjeje**

- Mësimi nga pengesat.
- Qetësia dhe paqja shpirtërore.
- Përballimi me kurajë i humbjes.

- Vetëdijesimi dhe jeta në të tashmen etj.
- Përqendrimi te virtyti dhe veprimet e drejta.
- Të pranojmë me qetësi atë që nuk mund të ndryshohet.
- Kontrolli i brendshëm, disiplinë mbi mendimet dhe ekuilibrimi i emocioneve.
- Bindje ndaj asaj që është përcaktuar të ndodh nga Arsyeja Hyjnore dhe mospërballja me situatat që nuk i kemi në kontroll.

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse shpjegon tri mënyra;  
**2 pikë** nëse shpjegon dy mënyra;  
**1 pikë** nëse shpjegon një mënyrë;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 32****Model përgjigjeje**

- Liria: Ai thekson rëndësinë e lirisë së mendimit dhe shprehjes, si dhe tolerancës ndaj mendimeve të ndryshme, duke e konsideruar lirinë një nga të drejtat themelore të njeriut në shoqëri.
- Barazia: Sipas tij, njerëzit janë të barabartë në të drejta dhe dinjitet, duke përfshirë idenë e barazisë midis individëve dhe rëndësinë e trajtimit të barabartë në shoqëri.
- Organizimi i pushtetit : Ai mbështet ndarjen e pushteteve për të shmangur abuzimin me autoritetin dhe thekson se qeveria duhet të mbrojë interesat e qytetarëve; në të kundërt, qytetarët kanë të drejtë të kundërshtojnë ose të ndryshojnë qeverinë.

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse vlerëson tri parime;  
**2 pikë** nëse vlerëson dy parime;  
**1 pikë** nëse vlerëson një parim;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 33****Model përgjigjeje****Model përgjigjeje****Roli i individit dhe të drejtat**

- Vendosija e njeriut dhe të drejtave të tij në qendër të shoqërisë; Në emër të lirisë u kërkua të mos ketë diskriminim dhe të garantohen të drejtat dhe paqja.
- Njeriu vlerësoi ekzistencën e tij si thelbësore në zhvillimin progresiv të botës.
- Psikanalitika e Frojdit dha një shpjegim të ri të strukturës dhe funksionimit të psikikës njerëzore;
- Marksi në filozofi do të themelonte materializmin dialektik, Kierkegard do diskutojë ekzistencën, ndërsa Niçe do të kritikonte moralin tradicional;

**Zhvillimi i rrymave filozofike**

- Rrymat e reja në shek. XX, si utilitarizmi do të ndihmonin njeriun të zbulonte veprimin e duhur për të ose filozofia pragmatiste që u përpoq të ndërtonte një kurrikul të re moderne që do të aftësonte nxënësit për jetën.

- Ndryshime në aspektin filozofik u vunë re në Angli me përfaqësues Bentamin dhe Millin në drejtim të filozofisë utilitariste.
- Në Francë mendimi filozofik u ndikuar nga revolucioni të vitit 1789 dhe zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike të cilat pasuan, duke u konsideruar si filozofi sociale. Megjithatë nën drejtimin e Ogyst Kontit u shfaq drejtimi i filozofisë pozitiviste.
- Në Gjermani nën ndikimin e zhvillimeve industriale të cilat dhanë efekte në aspektin socio-ekonomik ndikuan në mendimin filozofik të kohës. Përfaqësues i drejtimin të ri filozofik ishte Marksi me teorinë e materializmit historik.

### **Ndikimi i shkencës dhe teknologjisë**

- Shpikja dhe përdorimi i armëve bërthamore në Luftën e II Botërore, vuri në dyshim rolin e arsyes në progresin e shkencës dhe teknikës;
- Zhvillimi i vrullshëm i shkencave të natyrës dhe teknikës;
- Vepra e Darvinit "Mbi origjinën e llojeve" shpjegoi shkencërisht evolucionin e qenieve të gjalla iu kundërvu shpjegimeve fetare;
- Teoria e relativitetit të Ajshtajnit hodhi themelet e fizikës moderne dhe shpjegim të ri të universit dhe ligjeve të tij;

### **Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse shpjegon tri karakteristika;

**2 pikë** nëse shpjegon dy karakteristika;

**1 pikë** nëse shpjegon një karakteristikë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.